



## Tubacioni Trans Adriatik organizon takime të hapura me komunitetin mbi Procesin e Vlerësimit të Ndikimit Mjedisor dhe Social (VNMS)

Tubacioni Trans Adriatik (TAP) është një projekt tubacioni gazi natyror. Tubacioni TAP do të transportojë gaz nga rajoni i Kaspikut nëpërmjet Greqisë dhe Shqipërisë dhe përtej detit Adriatik, në Italinë e Jugut dhe më tej në Evropën Perëndimore. TAP do të hyjë në Shqipëri nga Greqia në Miras të rajonit të Korçës. Dalja në det do të bëhet në zonën bregdetare në veri-perëndim të Fierit.

Pas 2 vjetësh punë në Shqipëri për përzgjedhjen e gjurmës së përshtatshme për tubacionin, TAP po organizon Vlerësimin e Ndikimit Mjedisor dhe Social (VNMS) të detajuar dhe të integruar, i cili do të kryhet nga një grup ekspertësh shqiptarë dhe ndërkombëtarë në pajtim me ligjin shqiptar në përputhje me Politikën Mjedisore dhe Sociale të BERZH (Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim). Qëllimi i VNMS është të vlerësojë ndikimet e mundshme të projektit dhe aktivitetet e lidhura me projektin mbi mjedisin dhe burimet socio-ekonomike dhe të hartojë masa zbutëse ose inkurajuese për të shmangur, hequr ose ulur ndikimet negative në mjedis.

Kërkimet në terren mbi situatën mjedisore dhe socio-ekonomike të zonave ku kalon gjurma, do të fillojnë në qershor 2011 dhe do të vazhdojnë përgjatë muajve në vijim. Gjatë kësaj periudhe, ekipi i punës do të takohet me Qeverinë Shqiptare, autoritetet rajonale që kanë lidhje me projektin (Korçe, Berat dhe Fier), si dhe me përfaqësuesit e rretheve, bashkive, komunave dhe fshatrave të zonave ku kalon gjurma e propozuar e tubacionit.

**TAP dëshiron të takohet me çdo person të interesuar, i cili dëshiron të mësojë më shumë rreth projektit ose të japë reagimet e tij dhe për këtë arsye po organizon një sërë takimesh me komunitetin në vendndodhjet e mëposhtme dhe në datat respektive (takimet e mëtejshme do të njoftohen në ditët e ardhshme):**

### Korça

Data	Komuna	Vendndodhja	Ora	Vend takimi
07/06/2011	Mollaj	Komuna Mollaj/kamenice	9pd	Shkolla Lokale
		Uje I Bardhe	2md	Qendra Fshatit
		Uje I Bardhe Grup i perqendruar (Agrikulture/Fermere)	4md	Qendra Fshatit
08/06/2011	Drenove	Komuna Drenove	9pd	Shkolla Lokale
		Komuna Drenove Grup i Perqendruar (Mesues/Punonjes shendetesie)	11pd	
		Dardhe	2md	Shkolla Lokale
		Dardhe Grup i perqendruar (Turizem)	4md	
09/06/2011	Miras	Miras	9pd	Komuna
		Miras Grup i perqendruar (Agrikulture/Fermere)	11pd	

### Corovoda-Berat

Data	Komuna	Vendndodhja	Ora	Vend takimi
07/06/2011	Vendreshe	Vendreshe	9pd	Komune
		Vendreshe Grup i perqendruar (Agrikulture)	11pd	Komuna
		Therpele	2md	Shkolla Lokale
		Therpele Grup i perqendruar (Moshë e trete/Plegte)	4md	Shkolla Lokale
08/06/2011	Vendreshe	Vendreshe e Vogel Focus group ( Agriculture )	9pd	Qendra fshatit
		Vendreshe e Vogel Grup i perqendruar (Agrikulture)	11pd	Qendra fshatit
		Vale / Ustie	2md	Banese Private
		Vale / Ustie	4md	Banese Private
09/06/2011	Bogove	Komuna Bogove	9pd	

### Berat

Data	Komuna	Vendndodhja	Ora	Vend takimi
07/06/2011	Otlak	Komuna Otlak	9pd	Komune
		Komuna Otlak Grup i perqendruar (Pronare te tokave)	11pd	Komune
		Morave	2md	Shkolla Lokale
		Ullinjas	4md	Qendra Fshatit
08/06/2011	Ura Vajgurore	Guri I Bardhe	9pd	Qendra Kulturore
		Guri I Bardhe Grup i perqendruar (Pronare te tokave)	11pd	Qendra Kulturore
		Konisbalt/Vokopole	2md	Qendra Fshatit
		Konisbalt/Vokopole Grup i Perqendruar (Mesues/Punonjes shendetesie)	4md	Qendra Fshatit
		Konisbalt/Vokopole Grup i Perqendruar ( Grate)	6md	
09/06/2011	Poshnje	Komuna Poshnje	9pd	Komune

### Fier

Data	Komuna	Vendndodhja	Ora	Vend takimi
07/06/2011	Mbrostar	Mbrostar ura	9pd	Komune
		Mbrostar ura Grup i perqendruar (Agrikulture/Fermere)	11pd	Plantacionet e Ullinjve
		Petove	1md	Shkolla Lokale
		Verrri	4md	Shkolla Lokale
08/06/2011	Topoje	Seman	9pd	
		Seman I ri	11pd	
		Sheq-marinas	2md	
		Gryke	4md	
09/06/2011	Dermenas	Komuna Dermenas	9pd	Ne Qender te Komunes
		Komuna Dermenas Grup i Perqendruar (Grate)	11pd	Ne Qender te Komunes
		Hoxhare	2md	Qendra Fshatit
		Hoxhare Grup i Perqendruar (Mesues/Punonjes shendetesie)	4md	Qendra Fshatit

TAP gjithashtu mirëpret çdo lloj komenti nga palët e interesuara nëpërmjet rrugëve të mëposhtme të komunikimit:

Nëpërmjet emailit: [esia-comments@tap-ag.com](mailto:esia-comments@tap-ag.com)

Nëpërmjet postës: Trans Adriatic Pipeline AG – Albania (Zyra Përfaqësuese), Torre Drin, Rruga Abdi Toptani, Tirana, Shqipëri

Nëpërmjet faksit: + 355 42 265 685

Për informacione të mëtejshme, ju lutemi vizitoni [www.trans-adriatic-pipeline.com](http://www.trans-adriatic-pipeline.com)